



Tiranë më

Nr.

Prot.

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE
NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është parashikuar kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve.

Në zbatim të dispozitës së sipërcituar, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit ka përfunduar programin për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve si dhe ka hartuar projektvendimin “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Programi për edukimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025, përcakton qëllimin dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve përgjatë periudhës zgjedhore. Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave, gjithashtu reflekton punën dhe angazhimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin zgjedhor të shtetasve, në përmbushje të detyrës institucionale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara, ku edukimi dhe informimi i zgjedhësve është ndër komponentët kryesorë garantues për arritjen e standardeve të synuara.

Zbatimi i programeve të ndryshme për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, në një periudhë të përcaktuar kohe është një proces kompleks, suksesi i të cilit ndërvaret edhe nga kontributi i aktorëve të tjerë që mund të bashkëveprojnë në këtë fushë.

Duke marrë në konsideratë përhapjen në kohë reale të lajmeve të rreme në epokën digjitale dhe ndikimin negativ që ka disinformimi tek besueshmëria dhe pavarësia e zgjedhjeve, tek teknologjia që përdoret në procesin zgjedhor, etj, është me rëndësi zhvillimi i një fushatë të gjerë informimi

për këtë qëllim.

Programi për edukimin e zgjedhësve për zgjedhjet për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve mbi të gjithë procesin zgjedhor. Programet informuese do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të KQZ-së, me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë. Përfshirja e tyre në realizimin e programeve edukuese zgjedhore, ekspertiza, angazhimi dhe mbështetja e tyre vlerësohen si komponentë të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të KQZ-së.

Të gjitha të dhënat personale të zgjedhësve do të ruhen në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, kreu II, neni 5 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ky program përmban 10 (dhjetë) objektiva kryesorë, të ndara si më poshtë:

Pjesa e parë: Informimi i zgjedhësve për veprat penale në zgjedhje, veçanërisht për shit-blerjen e votës, si dhe ndërgjegjësimi i tyre për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti.

Pjesa e dytë Informimi mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.

Pjesa e tretë: Informimi dhe sensibilizimi i grupeve vulnerabël, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, kryesisht votues për herë të parë, gratë, etj, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në votime.

Pjesa e katërt: Informimi dhe sensibilizimi në gjuhën e pakicave i zgjedhësve përkatës.

Pjesa e pestë: Informimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve zgjedhore për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit për pjesëmarrjen në zgjedhje..

Pjesa e gjashtë: Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore, mbi financimin e e fushatave zgjedhore

Pjesa e shtatë: Informimi dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet për ta gjatë fushatës zgjedhore.

Pjesa e tetë: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit.

Pjesa e nëntë: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit.

Pjesa e dhjetë: Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

Sfidat e Programit

Sfidat kryesore të këtij programi janë realizimi dhe implementimi i plotë në të gjitha platformat e komunikimit i programit të edukimit. Aksesit që çdo zgjedhës të ketë në marrjen e informacionit të nevojshëm rreth procesit zgjedhor. Duke marrë në konsideratë afatet dhe konsensusin e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, zbatimi i këtij programi është sfida për përmbushjen e misionit të KQZ-së.

Bashkërendimi i projektvendimit

Projektvendimi iu dërgua për mendim partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat nuk kanë shprehur komente.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

Monika SINANI - Sektori i Informimit të Zgjedhësve
Ermina ALLUSHI- Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit
Pavlina DOÇAJ - Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA- Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

Prot.

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE
NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data:

Nr:

Ora:



“Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



Edukimi, Informimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve

ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025

Z G J E D H J E
2025



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



KQZ


Available on the
App Store

GET IT ON
Google Play

SLOGANI



**VOTO
TË DËGJOHESH!**



Z G J E D H J E 2025

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Programi për edukimin e zgjedhësve për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025, përcakton qëllimin dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve përgjatë periudhës zgjedhore.

Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave tona.

Zbatimi i programeve të ndryshme për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, në një periudhë të përcaktuar kohe është një proces kompleks, suksesi i të cilit ndërvaret edhe nga kontributi i aktorëve të tjerë që mund të bashkëveprojnë në këtë fushë.

Duke marrë në konsideratë përhapjen në kohë reale të lajmeve të rreme në epokën dixhitale dhe ndikimin negativ që ka disinformimi tek besueshmëria dhe pavarësia e zgjedhjeve, tek teknologjia që përdoret në procesin zgjedhor, etj, është me rëndësi zhvillimi i një fushatë të gjerë informimi për këtë qëllim.

Programi për edukimin e zgjedhësve për zgjedhjet për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve mbi të gjithë procesin zgjedhor.

Programet informuese do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të KQZ-së, me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë. Përfshirja e tyre në realizimin e programeve edukuese zgjedhore, ekspertiza, angazhimi dhe mbështetja e tyre vlerësohen si komponentë të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të KQZ-së.




QËLLIMI

Programi për edukimin e zgjedhësve, për Zgjedhjet për Kuvend 2025 , ka për qëllim promovimin e standarteve për zgjedhjeve të lira dhe të nderëshme, si dhe mirëinformimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor.

Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë zgjedhësit për parandalimin e veprave penale; të informojë dhe edukojë zgjedhësit për datën e zgjedhjeve duke i orientuar ata në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit ku ai voton; ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, pakicat kombëtare që jetojnë në vendin tonë me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje; të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe identifikimit elektronik; të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimi i zgjedhësve nga jashtë vendit për procedurën e regjistrimit dhe votimit. Gjithashtu ky program i drejtohet edhe subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për mënyrën e plotësimin të dokumentacionit të kandidimit.

Mjetet që do të përdoren për të arritur qëllimin dhe objektivat:



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



KQZshqiperi



kqz.gov.al



Objektivat kryesore të programit:

- 1** | Informimi i zgjedhësve për veprat penale në zgjedhje, veçanërisht për shit-blerjen e votës, si dhe ndërgjegjësimi i tyre për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti.
- 2** | Informimi mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.
- 3** | Informimi dhe sensibilizimi i grupeve vulnerabël, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, kryesisht votues për herë të parë, gratë, etj, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në votime
- 4** | Informimi dhe sensibilizimi në gjuhën e pakicave i zgjedhësve përkatës.
- 5** | Informimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve zgjedhore për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit për pjesëmarrjen në zgjedhje.
- 6** | Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore, mbi financimin e fushatave zgjedhore.
- 7** | Informimi dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet për ta gjatë fushatës zgjedhore.
- 8** | Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit.
- 9** | Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit.
- 10** | Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

Audienca e synuar:

Të gjithë zgjedhësit, që votojnë dhe kanë mbushur moshën 18 vjeç.

1

Informimi i zgjedhësve për veprat penale në zgjedhje, veçanërisht për shit-blerjen e votës, si dhe ndërgjegjësimi i tyre për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti.

• Grupi ku adresohet: Të gjithë zgjedhësit

Ky objektivi ka për qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë zgjedhësve, por jo vetëm, si dhe të subjekteve zgjedhore mbi veprat penale dhe shkeljet e tjera ligjore që mund të kryhen nga zgjedhësit apo subjektet zgjedhore përgjatë periudhës zgjedhore, si dhe sanksionet për këdo që kryen këto vepra penale. Fokusi më së shumti do të jetë tek shitblerja e votës si një vepër penale e rëndë dhe me sanksione të rrepta penale për ata që e kryejnë këtë vepër penale.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale. (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi parandalimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve.)



Takime me zgjedhësit (do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët do të informohen mbi veprat penale dhe si t'i parandalojnë.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni "denonco" ku cilido mund të denoncojë shkeljet e ndryshme zgjedhore.)



Web KQZ (në ëebsite e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi veprat penale.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot mbi veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor në televizionet kombëtare dhe lokale, si dhe në emisionet më të ndjekura.)



Postera në Qendër Votimi (Do të vendosen postera informues mbi veprat penale në zgjedhje, në të gjitha qendrat e votimit.)



City lights (Do të vendosen postera informues në pikat qendrore me lëvizje më të madhe të qytetarëve, mbi veprat penale në zgjedhje.)



Ledwall (Do të transmetohet spot mbi veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor në ledëall, në pikat me lëvizje më të madhe të qytetarëve në të gjithë vendin.)



Bus station (Do të vendosen postera informues në stacionet e autobusave në pikat kryesore të lëvizjes së qytetarëve mbi veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor.)

Materialet informuese për këtë objektivi do të përkthehen edhe në 8 gjuhët e pakicave kombëtare, gjithashtu edhe në gjuhën e shenjave për spotet.

• Periudha e zhvillimit të kësaj fushate: 1 Shtator 2024 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

2

Informimi mbi listën e zgjedhëse dhe qendrën e votimit.

• Grupi ku adresohet: Të gjithë zgjedhësit

Ky objektivi ka për qëllim të informojë zgjedhësit mbi listën e zgjedhëse dhe qendrën e tyre të votimit. Nëse zgjedhësit kanë pasaktësi në listë, të emrit apo vendbanimit, i jepet gjithë informacioni me hapat që ata duhet të ndjekin për ti ndryshuar. Gjithashtu informohen se ku duhet të drejtohen si dhe mjetet e ndryshme të komunikimit, ku ata mund të gjejnë gjithë informacionin mbi procesin zgjedhor.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi listën e zgjedhëse dhe qendrën e votimit)



Takime me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët do të informohen se ku mund të gjejnë emrin e tyre në listën e zgjedhëse dhe qendrën e votimit.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës nëpërmjet rubrikës "Ku votoj".)



Web KQZ (në website e kqz-së do të publikohet i gjithë informacioni mbi listën e zgjedhëse dhe nëpërmjet web-it mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot televiziv në televizionet kombëtare dhe lokale mbi listën e zgjedhëse dhe se për çdo pasaktësi që mund të ndeshin, ku do të drejtohen për ti rregulluar ato).



Spote radiofonike (Do të transmetohet spot mbi listën e zgjedhëse, për cdo pasaktësi që mund të ndeshin dhe se ku do të drejtohen për ti rregulluar ato në radiot më të ndjekura.)



Postera/Veshje autobusi (Do të vendosen postera/veshje autobusi informues mbi listën e zgjedhëse dhe qendrën e votimit.)



Banderola (Do të vendosen banderola informuese për listën e zgjedhëse dhe qendrën e votimit.)



Ledwall (Do të transmetohet spot mbi listën e zgjedhëse, për cdo pasaktësi që mund të ndeshin dhe se ku do të drejtohen për ti rregulluar ato, në akset kryesore.)



Stenda informuese (Do të vendosen postera informues për listën e zgjedhëse dhe qendrën e votimit në qendër fshat, ose në pikat ku marrin shërbime.)



Bus station (Do të vendosen postera informues në stacionet e autobuzave në pikat kryesore të lëvizjes së qytetarëve për listën e zgjedhëse dhe qendrën e votimit.)

Materialet informuese për këtë objektivi do të përkthehen edhe në 8 gjuhët e pakicave kombëtare gjithashtu edhe në gjuhën e shenjave për spotet.

• Periudha e zhvillimit të kësaj fushate: Nga afishimi i listës së zgjedhëse e deri në afatin përfundimtar të shfaqjes së saj



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi




KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



3 Informimi dhe Sensibilizimi i grupeve vulnerabël, personat me aftësi të kufizuar, të rinjtë, kryesisht votues për herë të parë, gratë, etj, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në votime.

- **Grupi ku adresohet:** Gratë, personat me aftësi të kufizuar, votuesit për herë të parë.

Ky objektivi ka në fokus sensibilizimin e zgjedhëseve gra, të rinjtë kryesisht votues për herë të parë, pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuar (PAK). Qëllimi është rritja e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje. Gjithashtu shmangia e fenomenit të votimit familjar, për të votuar në mënyrë të lirë dhe të pandikuar, si dhe përfshirja e tyre në proceset e ndryshme zgjedhore.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj për të gjithë target grupet e përfshira në këtë objektivi për pjesëmarrje në zgjedhje.)



Takime me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë, PAK dhe pakicat kombëtare, ku do të informohen mbi të gjitha hapat e procesit zgjedhor.)



App KQZ (Do të informohen që nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës, mund të denoncohet çdo parregullsi që mund të vërehet përgjatë procesit zgjedhor apo edhe ditën e zgjedhjeve.)



Web KQZ (Në ëbesite e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi procesin zgjedhor në rubrikën "Edukimi i Zgjedhësve".)



Spote televizive (Do të transmetohet në televizionet kombëtare dhe lokale spot mbi sensibilizimin e grupeve vulnerabël për të rritur besimin e tyre në zgjedhje dhe rritjen e pjesëmarrjes në proces. Gjithashtu i gjithë informacioni do të transmetohet edhe në gjuhën e pakicave kombëtare, nëpërmjet spoteve që do të transmetohen në tv lokale në zonat ku janë të përqëndruar pakicat, si dhe gjuhën e shenjave.)

- **Periodha e zhvillimit të kësaj fushate:** Janar 2025 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

4 Informimi dhe sensibilizimi në gjuhën e pakicave i votuesve përkatës.

• Grupi ku adresohet: Minoritetet

Ky objektivi ka në fokus sensibilizimin e zgjedhëseve që i përkasin pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë. Qëllimi është rritja e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje. Gjithashtu informimi në gjuhën që ata flasin për të gjitha hapat e procesit zgjedhor.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të shpërdahet informacioni nëpërmjet spoteve, banerave dhe mesazheve të ndryshme i përshtatur në 8 gjuhë të pakicave kombëtare, që jetojnë në vendin tonë).



Takim me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me zgjedhës të pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë, të cilët do të informohen mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve.)



App KQZ (Do të informohen që nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet qendra e votimit nga çdo zgjedhës, mund të denoncohet çdo parregullsi që mund të vërehet përgjatë procesit zgjedhor apo edhe ditën e zgjedhjeve.)



Web KQZ (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi procesin zgjedhor në rubrikën "Edukimi i Zgjedhësve".)



Postera në Qendër Votimi (Do të vendosen postera informues në gjuhën e pakicave kombëtare në zonat ku ata jetojnë)



Spote televizive (Do të transmetohen set e fushatës së edukimit të zgjedhësve, me titra në gjuhën e pakicave kombëtare, arumune, rome, greke, maqedonase, malazeze, serbe, boshnjake, vllahe etj. Gjithashtu i gjithë informacioni do të transmetohet edhe në gjuhën e pakicave kombëtare nëpërmjet spoteve në tv lokale në zonat ku janë të përqëndruar pakicat, si dhe gjuhën e shenjave.)

• Periudha e zhvillimit të kësaj fushate: Janar 2025 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

5 Informimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve zgjedhore për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit për pjesëmarrjen në zgjedhje.

- **Grupi ku adresohet:** Subjektet zgjedhore dhe kandidatët të propozuar nga subjektet zgjedhore

Ky objektivi ka për qëllim të informojë subjektet zgjedhore dhe kandidatët të propozuar nga subjektet zgjedhore për mënyrën e plotësimit të dokumentacionit të kandidimit për të marrë pjesë në zgjedhje. Gjithashtu të informohen, se ku mund të gjejnë lehtësisht të gjithë informacionin e nevojshëm për tu regjistruar në zgjedhje.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi plotësimin e dokumentacionit për kandidimin)



Takime me subjektet zgjedhore dhe kandidatët (Do të zhvillohen takime me kandidatët, kryesisht gratë të cilët do të informohen për mënyrën e plotësimit të dokumentacionit për të kandiduar në zgjedhje.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet lehtësisht dokumentatat e kandidimit dhe mënyra e plotësimit të tyre.)



Web KQZ (Në website e kqz-së janë të publikuara dokumentatat e kandidimit dhe mënyra e plotësimit të tyre.)

- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** Nga Janari 2025 deri në mbylljen e procesit të regjistrimit të subjekteve dhe kandidatëve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



6 Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore, mbi financimin e fushatave zgjedhore.

• Grupi ku adresohet: Partitë politike dhe të gjithë zgjedhësit

Ky objektivi ka në fokus informimin dhe sensibilizimin mbi financimin e subjekteve zgjedhore. Informimi i subjekteve zgjedhore mbi afatet dhe detyrimet ligjore, për dorëzimin e raporteve financiare vjetore dhe dorëzimin e raporteve financiare gjatë fushatës zgjedhore. Informimin e kandidatëve të pavarur për detyrimet ligjore për hartimin dhe dorëzimin e raporteve financiare për fushatën zgjedhore. Ndërgjegjësimin e subjekteve zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialeve propagandistike gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi financimin e subjekteve zgjedhore)



App KQZ (Do të informohen mbi dorëzimin e pasqyrave financiare nga subjektet zgjedhore dhe vendosjen e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore dhe sesioni "denonco" ku cilido mund të denoncojë shkeljet e ndryshme zgjedhore.)



Web KQZ (Në website e KQZ do të publikohet informacioni mbi financimin e subjekteve zgjedhore.)



Spote (Do të transmetohet spot informues mbi financimin e partive politike, që do të shpërndahet në tv kombëtare dhe lokale)

• Periudha e zhvillimit të kësaj fushate: Shtator 2024 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

7 Informimi dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet për ta gjatë fushatës zgjedhore.

• Grupi ku adresohet: Administrata publike qendrore dhe vendore

Ky objektivi ka për qëllim kryesor ndërgjegjësimin e punonjësve të administratës vendore gjatë periudhës zgjedhore, mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i çdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve shtetërore.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj për parandalimin e burimeve shtetërore përgjatë fushatës zgjedhore nga administrata vendore, si dhe parandalimi i pjesëmarrjes në fushatën zgjedhore i punonjësve shtetërorë përgjatë orarit zyrtar.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni “Denonco” shkeljet zgjedhore.)



Web KQZ (në Website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni mbi shkeljet dhe parandalimi i veprave penale nga ana zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike.)



Porstera (Do të vendosen postera informues në të gjitha bashkitë, dhe në Institucione që ofrojnë shërbime, mbi kufizimet që punonjësit e administratës shtetërore kanë gjatë orarit zyrtarë në fushatën e subjekteve zgjedhore.)

• Periudha e zhvillimit të kësaj fushate: Shtator 2024 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

8

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që ata duhet të ndjekin ata në procesin e votimit.

• **Grupi ku adresohet:** Të gjithë zgjedhësit

Qëllimi i këtij objekti është hapat që duhet të ndjekin zgjedhësit ditën e zgjedhjeve, nga momenti i paraqitjes në qendrën e votimit, dokumentat që duhet të kenë me vete dhe procedura e identifikimit elektronik.

• **Mjetet e komunikimit**



Media sociale. (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve.)



Takim me zgjedhësit (do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët do të informohen mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni “Si të votoj” i cili shpjegon me video të gjitha hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit.)



Web KQZ (Në ëebsite e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni në rubrikën “Edukimi i Zgjedhësve” mbi hapat duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot në televizionet kobëtare dhe lokale mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit)



Postera në Qendër Votimi (Do të vendosen në të gjitha qendrat e votimit, mbi hapat që duhet të ndjekë zgjedhësi në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve.)



City lights (Do të vendosen postera informues në pikat qendrore me lëvizje të dendur qytetarësh, mbi hapat që duhet të ndjek zgjedhësi në QV.)



Ledwall (Do të shfaqet spot mbi hapat që duhet të ndjek zgjedhësi në QV në ledëall, në pikat me lëvizje të dendur qytetarësh në të gjithë vendin.)



Bus station (Do të vendosen postera informues në stacionet e autobusave në pikat kryesore të lëvizjes së qytetarëve mbi veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor.)

Materialet informuese për këtë objektiv do të përkthehen edhe në 8 gjuhët e pakicave kombëtare gjithashtu edhe në gjuhën e shenjave për spotet.

• **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** Shtator 2024 deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



9

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit.

• Grupi ku adresohet: Të gjithë zgjedhësit

Qëllimi i këtij objekti është informimi i zgjedhësve mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit. Zgjedhësit do të sensibilizohen mbi mënyrën e saktë të plotësimit duke evituar pavlefshmërinë e votës së tyre.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale. (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit..)



Takim me zgjedhësit (Do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabel të cilët do të informohen mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni "Si të votoj" gjithë informacionin mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit.)



Web KQZ (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni në rubrikën "Edukimi i Zgjedhësve" mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot në televizionet lokale mbi mënyrën e plotësimit korrekt të fletës së votimit.)



Ledwall (Do të transmetohet spot në ledwall mbi mënyrën që do të votojnë me anë të pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik.)

Materialet informuese për këtë objektiv do të përkthehen edhe në 8 gjuhët e pakicave kombëtare, gjithashtu edhe në gjuhën e shenjave për spotet.

• Periudha e zhvillimit të kësaj fushate: Nga momenti i përcaktimit të llojit të fletës së votimit deri ditën e zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

10

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

- **Grupi ku adresohet:** Të gjithë zgjedhësve të bashkive ku do të pilotohet projekti

Qëllimi i këtij objekti është që zgjedhësit të informohen mbi të gjitha hapat e votimit nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik. Kjo fushatë do të përqëndrohet vetëm në ato zona ku do të zbatohet ky projekt.

• Mjetet e komunikimit



Media sociale. (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst, video, audio, etj mbi identifikimin elektronik të zgjedhësve dhe votimin dhe numërimin elektronik.)



Takim me zgjedhësit/testimi i pajisjes (do të zhvillohen takime me votues për herë të parë, gratë dhe grupe të ndryshme vulnerabël të cilët do të informohen mbi votimin elektronik dhe sigurinë që pajisja ka.)



App KQZ (Nëpërmjet aplikacionit mund të gjendet sesioni “Si mund të votoj” i cili shpjegon me video të gjitha hapat duhet të ndjekin zgjedhësit që do të votojnë me anë të pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik.)



Web KQZ (në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni në rubrikën “Edukimi i Zgjedhësve” mbi hapat që duhet të ndjekin zgjedhësit që do të votojnë me anë të pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik.)



Spote televizive (Do të transmetohet spot në televizionet lokale ku do të pilotohet ky projekt mbi përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik dhe mënyrën se si do të votohet me anë të pajisjes.na.)



Ledwall (Do të transmetohet spot në ledëall mbi përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik dhe mënyrën se si do të votohet me anë të pajisjes.)



Postera në Qendër Votimi (Do të vendosen në të gjitha qendrat e votimit, mbi përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik dhe mënyrën se si do të votohet me anë të pajisjes)



City lights (Do të vendosen postera informues në pikat qendrore me lëvizje të dendur qytetarësh, mbi përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik dhe mënyrën se si do të votohet me anë të pajisjes.)



Bus station (Do të vendosen postera informues në stacionet e autobusave në pikat kryesore të lëvizjes së qytetarëve mbi përdorimin e pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik dhe mënyrën se si do të votohet me anë të pajisjes.)

Materialet informuese për këtë objektiv do të përkthehen edhe në gjuhët e pakicave kombëtare, bazuar në zonat ku do të pilotohet projekti dhe në gjuhën e shenjave për spotet.

- **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** Nga momenti i miratimit të fletës së votimit deri ditën e zgjedhjeve.



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

Z G J E D H J E
2025



Edukimi, Informimi dhe
Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve



2 0 2 4